



VENDIM

Nr. 74, Datë 23.05.2017

MBI

**KËRKESËN E OST SH.A. PËR RISHIKIMIN DHE
KORRIGJIMIN E VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 52
DT. 06.04.2017 “MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMIT NR.
190, DATË 22.12.2016, TË BORDIT TË ERE-S, DERI NË
31.12.2017”.**

Në mbështetje të neneve 16 pika 5 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe nenit 16 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.05.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me kërkesën e shoqërisë OST sh.a., për rishikimin dhe korrigjimin e Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 52 datë 06.04.2017 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”.

Konstatohet se:

- ERE me Vendimin me nr.52, datë 06.04.2017, vendosi “Lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”.
- Me shkresën Nr.2256 Prot. Date 25.04.2017, OST sh.a I kërkoi ERE-s rishikimin dhe korrigjimin e Vendimit të Bordit nr.52, datë 06.04.2017 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017”, në lidhje me tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2017 si dhe detyrimit të OSHEE sh.a për shlyerjen e detyrimeve korente si dhe detyrimeve të prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a.
- OST sh.a. ka paraqitur pretendimin që lidhet me mospërfshirjen në Vendimin nr.52, datë 06.04.2017 të Bordit të ERE-s, të shlyerjes nga ana e

OSHEE sh.a të detyrimeve të prapambetura ndaj OST sh.a me qëllim shlyerjen e kredive nga OSTsh.a., ashtu siç parashikuar në Vendimin e Bordit të ERE me nr.111, datë 01.07.2016 *“Mbi Lënien në Fuqi të Vendimeve Nr .139, Nr. 141, Nr. 145, Nr.146, Nr.147, Nr. 148 Datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-S për Periudhën 1 Korrik 2016-31 Dhjetor 2016”*, si dhe Vendimin e Bordit të ERE nr.190, datë 22.12.2016 *“Mbi Lënien në Fuqi të Vendimeve Nr .139, Nr. 145, Nr.146, Nr. 147, Nr. 148 Datë 26.12.2014 të Bordit Të Komisionerëve të ERE -S, Vendimit Nr. 13 Datë 16.02.2016, Vendimit Nr.128 Datë 29.07.2016 të Bordit të ERE-s Deri Në 31.03.2017”*.

- ERE konstaton se, pavarësisht problemeve të shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ndaj shoqërisë OST sh.a., tarifa e transmetimit të energjisë elektrike, llogaritet mbi bazë të të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë dhe jo mbi bazën e fluksit të mjeteve monetare.
- Në shkresën e MEI-t, nr. 682/2 prot, datë 03.04.2017, në cilësinë e institucionit përgjegjës për hartimin e politikave të sektorit, me të cilin ERE bashkëpunon në zbatim të përcaktimeve të nenit 10 pika 2 të Ligjit nr.43/2015 *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, ka vlerësuar mbajtjen e të njëjtit regjim tarifor për vitin 2017 për të tre kompanitë, duke u shprehur ndër të tjera se, kjo vendimarrje ka jo vetëm rëndësi strategjike për sektorin por edhe do të garantonte zhvillimin normal të aktivitetit të shoqërive deri në përmbyllje të proceseve të nisura në kuadër të reformave sektoriale.
- Vendimi i ERE-s nr.52, datë 06.04.2017, në pikën 1 të tij ka përcaktuar, shtyrjen deri në 31.12.2017 të fuqisë juridike të vendimit Nr. 190 datë 22.12.2016, *“Për lënien në fuqi të tarifave dhe çmimeve të përkobëshme të energjisë elektrike të miratuara me Vendimet Nr .139, Nr. 145, Nr.146, Nr.147, dhe Nr.148 datë 26.12.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s”*.
- Në pikën 4, të Vendimit Nr. 190, datë 22.12.2016, përcaktohet se, OSHEE sh.a, përveç shlyerjes së detyrimeve korente, duhet të kryejë edhe pagesat ndaj KESH sh.a. dhe OST sh.a. nga detyrimet e prapambetura për qëllime të pagesave të kredive nga OST sh.a dhe KESH sh.a. Sa më sipër zgjidh edhe shqetësimin e ngritur nga OST për mosadresim në Vendimin nr.52, datë 06.04.2017, të Bordit të ERE, të çështjes së shlyerjes së detyrimeve të prapambetura dhe atyre korrente.

- Sa më sipër përcjellë nga shoqëria “OST” sh.a. nuk përbën provë të re dhe as konstatim të gabimeve materiale të tilla që të çojnë Bordin e ERE në marrjen e një vendim të ndryshëm nga ai nr.52, datë 06.04.2017 “*Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190, datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017*”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së Shoqërisë OST sh.a. për rishikimin dhe korrigjimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr.52, datë 06.04.2017 “*Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s, deri në 31.12.2017*”.
2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.